



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2081/7 prot.

Elbasan, me 22.09.2023

VENDIM

Nr 33 datë 22.09.2023

Për

ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2022-2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, Bordi i Administrimit me vendim nr 34 datë 04.11.2022 "Për ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", Për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: Ulje tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2022-2023, të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve, për program të parë studimi", Bordi i Administrimit, Relacionit datë 22.09.2023 "Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2022-2023. (verifikim dokumentacioni)"

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 82 studentë me rezultate (mesatare 9-10-të) brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 177 studentë me kriteret të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë ulje tarife shkollimi 40 studentë, për arsye të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara, sipas listës bashkëlidhur.



KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI

